

MBËSHËTETJE PËR PAGESËN E QERSË

Mbështetje për qeranë

<https://sociale.comune.fi.it/sostegno-canone-locazione>

Nga dita e hënë 20 Prill do të jetë e mundur të paraqisni kërkesën, eskuzivisht online deri në orën 24 të 11 majit. Kjo masë e jashtëzakonshme për pagesën e qerasë i drejtohet punonjësve të vartur dhe të vetëpunësuar të cilët si pasojë e urgjencës të shkaktuar nga Koronavirus kanë pushuar, pakësuar ose pezulluar aktivitetet e tyre ose mardhëniet e tyre të punës.

Kontributi do të mbulojë 50% të qerasë së banesës dhe gjithsesi nuk do të kalojë shumën prej 300 euro në muaj. Nëse qeraja është 1000 euro, kontributi mund të jetë maksimumi, k 300 euro në muaj. Kontributi korrespondon me tre muaj pasues duke filluar nga prilli 2020 (prill/maj/qeshor) Domethënë $300 \times 3 = 900$ euro.

Për të paraqitur kërkesën është e detyrueshme:

1. të jesh me vendbanim në Firenze, në banesën për qeranë e së cilës kërkohet kontributi;
2. të dispononi një kontratë qeraje për përdorim banese, të regjistruar regullisht, e cila i përket strehimit në të cilën figuron vendbanesa;
3. të mos keni të drejta pronësie ose uzufukti, përdorimi ose banimi në një shtëpi të përshtaçme për nevojat e trungut familjar, të vendosura në një distancë prej 50 km ose më pak;
4. të keni një vlerë lse (me një E, d.m.th që i përket të GJITHË trungut) të trungut familjar që nuk e kalon shumën prej a 28.684,36 euro; shiko FAQ 20, 21, 22;
5. të keni një ulje të të ardhurave familjare jo më pak se 30% për arsye që i atribuohen urgjencës epidemiologjike nga Covid-19. Ky pakësim mund ti referohet si të ardhurave nga një punë e vartur (ulja e orëve të punës, pagesë papunësie (cassa integrazione), etj...), ashtu dhe të ardhurat nga një vetpunësim (dhe bëhet fjalë në veçanti për kategoritë ATECO veprimtaria e të cilave është pezulluar pas masave të qeverisë), gjithashtu të ardhurave nga puna me kontratë pune jo për një kohë të papërcaktuar të çdo lloji tipologjie;
6. trungut familjar nuk duhet ti jet dorëzuar banesa ERO (CASE POPOLARI).
7. Mund të prezantohet vetëm një kërkesë për trung familjar.
8. Përfituesit e kësaj mase të jashtëzakonshme mund të paraqisin kërkesën, gjithashtu, për njoftimin e kontributit të qerasë 2020. Shuma e paguar si masë e jashtëzakonshme do të zbritet nga shuma që ju takon në bazë të njoftimit për kontributin e qerasë 2020.
9. Për të hyrë në procedurën online për të aplikuar për kontributin e jashtëzakonshëm është e nevojshme: shiko FAQ 15;
10. Kërkesa duhet të shoqërohet nga dokumentat e mëposhtme: shiko FAQ 17.18.19.

Për sa i përket vlerës lse, në kërkesë duhet të shënohet numri i protokollit Dsu (Deklarata zëvendësuese e Vetme), të cilën mund ta merrni edhe online në faqen e Inps (me konsulencën telefonike të mundur nga ana e një CAAF ose nga shoqatat e qiramarrësve, TË RENDITURA MË POSHTË). Asistencë për mbushjen e kërkesës:

SUNIA – Rruga delle Porte Nuove 15/a, 50144 Firenze. Tel. 055367904 / 055368573; adresa e postës elektronike sunia@suniafirenze.it Sunia do të jetë hapur rregullisht për publikun nga dita e hënë 20 (me masat e nevojshme shëndetsore) dhe do të ndjekë orarin në vazhdim: nga e hëna deri të premten nga ora 8:30 deri në orën 12:30.

SICET - rruga Carlo del Prete 135 dhe Sheshi dell'Indipendenza 21p 3. Nr. telefoni 3393090950 duke fiksuar takim.

Sicet Firenze sicetfirenzeprato@gmail.com

CONIA - CONIA FIRENCE Rruga Sant'Angelo, 17 – Firenze. Me anë të një takimi telefonik përveç numrit 055/753386, edhe në këtë numër 371.4427144; mbushja nuk është falas

conia.firenze@alice.it

FAQ MASË E JASHTËZAKONSHME PËR MBËSHTETJE NË PAGESËN E QERASË

Kujt i drejtohet kontributi i jashtëzakonshëm?

Punonjësve të vartur dhe të vetpunësuar që si pasojë e urgjencës epidemiologjike nga Covid-19 kanë **pushuar, pakësuar ose pezulluar aktivitetet e tyre ose raportin e tyre të punës.**

1. Sa duhet të jetë ulja e të ardhurave të trungut familjar?

Ulja e të ardhurave të trungut familjar duhet të rezultojë jo më pak se 30% (tridhjet përqind) për arsye që i atribuohen urgjencës epidemiologjike të Covid-19.

2. Ulja e të ardhurave i drejtohet të gjithë punonjësve?

Ulja mund të drejtohet si të ardhurave nga puna e vartur (pakësimi i orarit të punës, pagesa e papunësisë (cassa integrazione, etj...), ashtu dhe të ardhurave nga vetpunësimi (me referim të veçantë kategorive ATECO aktiviteti i të cilave është pushuar si pasojë e masave të marra nga shteti), gjithashtu të ardhurave nga puna me kontratë të përcaktuar ose me çdo llojë tipologjije tjetër.

3. Si duhet të veprojnë nëse nuk gjejnë aktivitetin tim midis kodeve ATECO?

Kodi ATECO i një aktiviteti i pushuar nga D.L.18/2020 është vetëm një nga mundësitë për të arsyetuar humbjen e të ardhurave, nuk është ekskluzive ose e nevojshme. M.gj.th, dhe në rastin e vetçertifikimit që i drejtohet një aktiviteti “tjetër”, duhet të ketë një arsye të verifikueshme (edhe më pas) që justifikon pakësimin e të ardhurave.

4. Duhet të jem me vendbanim në Firenze?

Po, është e nevojshme të keni regjistruar vendbanimin (residenza) në komunë, në banesën për të cilën kërkohet kontributi i qerasë.

5. Është e nevojshme të disponoj një kontratë qeraje?

Po, është e nevojshme të disponosh një kontratë qeraje për përdorim strehimi, të regjistruar regullisht, dhe që i referohet shtëpisë në të cilën rezulton vendbanimi.

6. Kontributi vlen edhe për kontratat me qera të akorduar?

Po, megjithatë janë kontrata qeraje private.

7. Kontributi vlen edhe për kontratat me kuponin e thatë (cedolare secca)?

Po, megjithatë janë kontrata qeraje private.

8. Mund të kërkohet kontributi nëse je një punonjës me vendbanim diku tjetër, por me një kontratë qeraje në Firenze për nevoja pune?

Jo, është e nevojshme të keni vendbanimin (residenza) në banesën për të cilën kërkohet kontributi.

9. Mund të kërkohet kontributi nëse je pronarë të pasurive të patundshme?

Është e mundur, me kusht që nuk ke të drejta pronësie, uzufukti, përdorimi ose banimi në një banesë të përshtatshme për nevojat e trungut familjar, të vendosur në një distancë të barabartë ose më pak se 50 Km.

10. Egziston një kriter thelbësorë?

Po, vlera ISE e trungut familjar nuk duhet të jetë më shumë se 28.684,36 euro.

11. Mund të kërkohet kontributi nëse të është dorëzuar një banesë ERP?

Jo, ky lloj kontributi nuk i drejtohet qiramarrësve ERP të cilët mund të përfitojnë ndihma të tjera në rast të reduktimit të të ardhurave.

12. A mund të kombinohet me kontributin për autonominë e të rinjve nga masa GiovaniSì në lidhje me pagesën e qerasë të banesës autonome?

Jo, nuk mund të kombinohet.

13. Përfituesit e masës së jashtëzakonshme do të mundën të paraqsin kërkesën dhe për njoftimin e kontributit të qerasë 2020?

Po, sidoqoftë shuma e paguar si masë e jashtëzakonshme do të zbritet nga shuma që ju takon në bazë të njoftimit për kontributin e qerasë 2020.

14. Si dërgohet kërkesa?

Kërkesa mund të dërgohet vetëm *online*, duke filluar nga ora 9 e të hënës 20 prill deri në orën 23:59 e 11 majit 2020.

15. Si futesh në procedurat *online*?

Futesh në procedurat *online*, duke alternuar mënyrat e mëposhtme:

- A) **Me anë të të dhënave të Sistemit Publik të Identitetit Dixhital (SPID):** për informacion mbi mënyrën e lëshimit dhe të përdorimit këshillohet të lidheni me adresën e mëposhtme:

<https://www.spid.gov.it/>

B) **Kartën Nazionale e Shërbimeve (CNS):** për informacion mbi mënyrën e lëshimit dhe të përdorimit këshillohet të lidheni me adresën e mëposhtme:

<http://www.regione.toscana.it/-/carta-nazionale-dei-servizi>;

- C) **Kartën e identitetit elektronike (CIE):**

për informacion:

<https://servizi.comune.fi.it/servizi/scheda-servizio/carta-di-identita-elettronica-cie>

D) **Me anë të të dhënave të hyrjes të lëshuara nga Komuna:** të gjitha informacionet për lëshimin mund ti gjeni në adresën e mëposhtme:

<http://centroservizi.lineacomune.it/portal/page/portal/Registrazione/Index>

16. Sa kërkesa mund të paraqiten?

Mund të paraqitet vetëm një kërkesë për trungun familjar.

17. Çfarë duhet ti bashkangjitet kërkesës?

Kërkesës duhen ti bashkangjiten:

- A. **E DETYRUESHME:** kopia e kontratës së qerasë për përdorim strehimi, të regjistruar, regullisht, duke ju referuar banesës ku në të cilën figuron vendbanimi i kërkuesit; Nëse nuk bashkangjiten dokumentat e detyrueshme, nuk do jetë e mundur të dërgoni kërkesën.
- B. **FAKULTATIV:** dokumenti që vërteton uljen e të ardhurave jo më pak se 30% në lidhje me aktivitetin e punës duke filluar nga 31 janari i 2020 dhe pagesat mujore përkatëse për vitin 2019, në rastet kur është e mundur. Është e mundur gjithashtu të deklaroni që merrni kontributin e papunësisë (cassa integrazione) pa bashkangjitur asgjë. Për të vetpunësuarit është e mjaftueshme të fusini të dhënat e aktivitetit dhe të vetçertifikoni uljen e të ardhurave prej 30%.
- X. **Nëse nuk bashkangjiten dokumentat fakultative, m.gj.th mundet të niset kërkesa.**
- Δ. **E DETYRUESHME:** mundësisht, çertifikimi që vërteton invaliditetin e barabartë ose më shumë se 67% në trungun familjar dhe/ose verifikimin e aftësive të kufizuara. Nëse nuk bashkangjiten dokumentat e detyrueshme, nuk do jetë e mundur të dërgoni kërkesën.

18. Është e mjaftueshme të shënoni numrin e protokollit e DSU?

Në kërkesën *online* është e mjaftueshme të shënoni numrin e protokollit të DSU (Deklarata Zëvendësuese e Vetme) të 2019 ose, si alternativë, atë të 2020, ndërkohë vlera e ISE do të shkarkohet direkte nga faja e internetit të INPS.

19. Si veprohet për të mbushur DSU?

DSU (Deklarata Zëvendësuese e Vetme) mund të mbushet edhe *online* në faqen e internetit të INPS (me anë të konsulencës telefonike të mundshme nga ana e CAAF ose të shoqatave të qiramarrësve të cilat do të shënohen në skadat e shërbimit.

20. Çfarë ndodh kur vlera ISE është më e lartë se 28.684,36 euro?

Në këtë rast, nuk do të lejohet të procedohet më tej me dërgimin e kërkesës.

21. Komuna do të kryej verifikime në një kampion të rastësishëm?

Po, Komuna do të kryej verifikime në një kampion të rastësishëm me anë të konsultimit të të dhënave nga administratat publike të tjera ose me anë të të dhënave që disponon vet Komuna.

22. Sa është shuma e kontributit?

Kotributi do të mbulojë 50% të pagesës së qerasë dhe, m.gj.th. do të jetë jo më shumë se 300 €/në muaj. Për shembull, nëse qeraja është 1000 euro kontributi mund të jetë maksimumi 300 euro në muaj.

Kotributi korrespondon me 3 muaj pasues duke flluar nga prilli 2020 dhe do të vazhdojë të jepet vetëm nëse kriteret që bëjnë të mundur përfitimin e këtij kontributi vazhdojnë të përmbushen, deri në aprovim e listës definitive, deri në maksimum 900 euro.

23. Si është e formuar lista?

Lista është e formuar në bazë të vlerës ISE që rezulton nga Çertifikacioni Isee i lëshuar nga INPS.

24. Në rast barazie të vlerës së ISE midis dy ose më shumë trungjeve familjare, si vendoset pozicioni në listë?

Pozicioni do të vendoset në bazë të kriterëve të mëposhtme të cilët mund të japin prioritetin dhe që aplikohen si më poshtë:

- Numri dhe mosha i të miturve të pranishëm në trungun familjar: ka prioritet trunq me një numër më të lartë të të miturve dhe me moshë më të ulët.
- Prania e personave me invaliditet të barabartë ose më shumë se 67% në trungun familjar dhe/ose me verifikimin e aftësive të kufizuara në bazë të L.5 shkurt 1992, n.104.

25. Kur është parashkuar aprovimi i listës?

Komuna aprovon listën për një kohë sa më të shkurtër mbas hetimit paraprak të kërkesave të pranuar, dhe, m.gj.th, brenda 30 dtëve nga skadenca e kohës së paraqitjeve të kërkesave.

26. Si kryhet pagesa e kotributit?

Komuna parashikon pagesën e drejtë për drejtë të kotributit ndaj përfituesve të përcaktuar në bazë të listës, deri në mbarimin e burimeve në dispozicion. Në rastin kur burimet në dispozicion nuk bëjnë të mundur pagesën e kontributit ndaj të gjithë përfituesve, Komuna i dërgon listën Qarkut (Regione), të kompletuar me shënimin e përfituesve të cilëve i është paguar kotributi dhe, si pasojë, të atyre për të cilët nuk qe e mundur.